REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr.730 prot. Prrenjas më 01.03.2022

URDHËR

Nr.154, datë 01/03/2022

"Për delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, Zv/Kryetarit Z.Aurel Karriqi"

Në mbështetje të:
- Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, neni 64 , të ndryshuar
- Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 28, neni 29

URDHËROJ :

1.Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë, zëvendës kryetarit z.Aurel Karriqi, për të firmosur korespondencat shkresore dhe të monitorojë dhe ndjekë mbarëvajtjen e punës për drejtoritë si më poshtë :
- Drejtoria e Infrastrukturës së Rrugëve dhe Mbrojtjes Civile
- Drejtoria e Shërbimeve Publike

2.Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë, zëvendës kryetarit z.Aurel Karriqi për firmosjen e urdhër- furnizimit.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Zv/Kryetari z.Aurel Karriqi .

4. Zv/Kryetari z.Aurel Karriqi nuk mund të nëndelegojë kompetencat .

5. Një kopje e këtij urdhri ti komunikohet Zv/Kryetarit z. Aurel Karriqi, ndërsa një kopje të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas, *www.bashkiaprrenjas.gov.al*.

6.Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar, dhe kompentencat do të mbarojnë me revokimin e aktit të delegimit.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. 729 **prot.** **Prrenjas më** 01.03.2022

URDHËR
Nr. 153 **, datë** 01 / 03 **/2022**

"PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË KRYETARIT TË BASHKISË PRRENJAS, ZV.KRYETARIT Z.ALBAN ÇEKREZI"

Në mbështetje të:
- Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, neni 64 , i ndryshuar
- Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 28, neni 29
- Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2021 "Për Prokurimin Publik" , neni 21 pika 5
- VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik " i ndryshuar

URDHËROJ :

1.Delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë Bashkisë Prrenjas, zëvendës kryetarit të Bashkisë Prrenjas z.Alban Çekrezi, për të firmosur , si personi i autorizuar , (titullar i autoritetit kontraktor) ,për të gjitha proçedurat e prokurimit, çdo korespondencë shkresore dhe të monitorojë dhe ndjekë mbarëvajtjen e punës për drejtoritë si më poshtë :
- Drejtoria e Shërbimit Pyjor/Kullotave / Bujqësisë Dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
- Drejtoria Juridike/Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerezore

2. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Zv.Kryetari Z.Alban Çekrezi.

3. Zv.Kryetari Z.Alban Çekrezi nuk mund të nëndelegojë kompetencat .

4. Një kopje e këtij urdhëri ti komunikohet Zv.Kryetarit Z.Alban Çekrezi, ndërsa një kopje të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas, *www.bashkiaprrenjas.gov.al*.

5.Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar, dhe kompentencat do të mbarojnë me revokimin e aktit të delegimit.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA